



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:030352

Datë: 18.09.2018

Numri i dokumentit: 00136412

P.nr.703/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. G.nga Gjakova, për shkak të veprës penale, të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.1906/2016, të datës 24.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **18.09.2018**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, në të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S. G.**, i biri i R. dhe i ëmës S., e gjinisë S, data e lindjes në Gjakovë, nuk ka leje të njoftimit, ku dhe tani banon në rrugën, egjiptian, shtetas i R. të Kosovës, din shkrim dhe lexim, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, i pa martuar .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse: Me datë 31.10.2015 rreth orës 14.00 minuta në fshatin D. K.Gjakovë, me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim vjedhje, i merr pasurinë të dëmtuarit P. M. N.nga fsh.D. K.Gjakovë, në atë mënyrë që i merr derën e hyrjes metalike të arës, ashtu që duke kërkuar hekura për shitje shkon te shtëpia e të dëmtuarit, e duke mos u diktuar nga i dëmtuari i merr këtë derën hyrëse të cilën e merr për shitje, e pas veprimeve operative policore dera gjendet e i kthehet të dëmtuarit.

- me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes, nga neni 325 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52 par.5, 73, dhe nenit 325 par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, i shqipton;

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.-(Njëqindë)Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(Një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës.

I dëmtuari P. M. N.nga fsh.D. K.Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1906/2016, të datës 24.10.2017, kundër të akuzuarit S. G.nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje, nga neni 325 par.1 të KPRK-së. Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj i ka propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari S. G.në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron, se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem për të cilën vepër jam penduar pa masë por premtoi para gjykatës se kjo do të jetë hera e fundit që kam kryer një vepër të tillë, është e vërtetë që kam marr derën metalike te i dëmtuari P. N., por kam menduar se ajo derë nuk i hyn në përdorim dhe të njëjtën e kam marr dhe e kam shitur në hekurishte që të fitoi disa para, pasi që jam në gjendje tejet të vështirë ekonomike, dhe parat më kanë nevojitur që të blej bukë, andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh këto rrethana me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet në faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari S. G.: Me datë 31.10.2015 rreth orës 14.00 minuta në fshatin D. K.Gjakovë, me qëllim që vetit apo tjetrit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm me qëllim vjedhje, i merr pasurinë të dëmtuarit P. M. N.nga fsh.D. K.Gjakovë, në atë mënyrë që i merr derën e hyrjes metalike të arës, ashtu që duke kërkuar hekura për shitje shkon te shtëpia e të dëmtuarit, e duke mos u diktuar nga i dëmtuari i merr këtë derë hyrëse të cilën e merr për shitje, e pas veprimeve operative policore dera gjendet e i kthehet të dëmtuarit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: moshën e tij e re në kohën e kryerjes së veprës penale, gjendjen e dobët ekonomike, është i pa punë, pranimin e fajit, pendimin e tij të thellë për veprën e kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën e tillë penale, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës, sjelljet tejet korrekte në gjykim, sendin e vjedhur ia ka kthyer të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë rënduese Gjykata ka marrë parasysh motivet për kryerjen e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljet e mëparshme të kryesit, i njëjti më parë ka qenë i dënuar për një veprë tjetër penale, andaj duke marrë parasysh këto rrethana, Gjykata të njëjtit i shqiptoj dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muajve**, dhe dënim me gjobë në shumë prej **100.- (Njëqindë)Euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (Një) viti**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, me bindje se edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, Gjykata e mori në mbështetje të nenit 453 par.4 të KPPK-së, nga se detyrimi që ti paguaj shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit dhe personave që ata detyrohen të mbështesin materialisht.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.703/17, me datën 18.09.2018

Procesmbajtësja,
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:030352
Datë: 18.09.2018
Numri i dokumentit: 00136412